

20212944635

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SË FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 104/19, 146/19, 275/19 dhe 311/20) në nenin 11 fjalët: “pengesa në zhvillimin trupor dhe mental” zëvendësohen me fjalën: “aftësi e kufizuar”.

Neni 2

Neni 32 ndryshon si më poshtë:

“(1) Për fëmijë me aftësi të kufizuara deri në moshën 26 vjeç, sigurohet shtesë e veçantë si kompensim në para.

(2) Konstatim dhe mendim për nevojën e realizimit të shtesës së veçantë jep Shërbimi i Vlerësimit Funkcional, në përputhje me Ligjin e Përkujdesjes Sociale.”.

Neni 3

Neni 33 ndryshon si më poshtë:

“Fëmijë me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, është fëmija me:

- pengesa në zhvillim trupor (të rënda, më të rënda dhe shumë të rënda në zhvillimin trupor),
- aftësi të kufizuara intelektuale (mesatare, të rënda dhe më të rënda),
- forma shumë të rënda të sëmundjeve kronike me të dëmtimeve të pranishme dhe të aktivitete të kufizuara,
- shikim të dëmtuar (të verbër dhe praktikisht të verbër),
- dëgjim të dëmtuar (praktikisht të shurdhër dhe krejtësisht të shurdhër),
- me mungesë të plotë të të folurit, me të folur të dëmtuar rendë, me të folur të humbur ose të dëmtuar më parë
- autizëm dhe
- më shumë lloje të aftësive të kufizuara (aftësi të kufizuara të kombinuara në zhvillim)”.

Neni 4

Në nenin 33-a fjalët: “pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike” ndryshohen me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Neni 5

Ne nenin 34 paragrafi (1) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohet fjalët “përveç në shtëpi nxënësish ose institucion tjetër nëse fëmija duhet ta vazhdojë arsimin e detyrueshëm.”.

Në paragrafin (2) fjalët: “pengesa në zhvillim dhe me nevoja specifike” ndryshohen me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Neni 6

Në nenin 35 paragrafët (2) dhe (3), fjalët: “nevoja specifike që ka pengesa në zhvillimin trupor dhe mental ose me pengesa të kombinuara në zhvillim” ndryshohet me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Neni 7

Në nenin 60 paragrafi (2) pika në fund të fjalisë ndryshohet me presje dhe shtohen fjalët “gjatë kësaj jepet përparësi për fëmijën me aftësi të kufizuara për të cilën ka paraqitur konstatim dhe mendim nga Shërbimi i Vlerësimit Funkcional, në përputhje me Ligjin e Përkujdesjes Sociale, me rekomandim për pranim.”.

Në paragrafin (10) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “respektivisht konstatim dhe mendim nga Shërbimi për vlerësim funksional, në përputhje me igjin për Mbrojtje Sociale, për fëmijë me aftësi të kufizuara.”.

Në paragrafin (11) fjalët: “pengesa në zhvillim” zëvendësohet me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Neni 8

Në nenin 64 paragrafi (4) fjalët: “pengesa të lehta respektivisht mesatare në zhvillimin intelektual dhe/ose pengesa trupore” fshihen.

Neni 9

Në nenin 66 paragrafi (3), pas fjalës: “Ministria” shtohen fjalët: pas kërkesës së parashtruar prej themeluesit”.

Neni 10

Në nenin 74 paragrafi (2), fjalët “nevoja të veçanta” ndryshohen me fjalën “aftësi të kufizuara”.

Neni 11

Në nenin 76 paragrafi (3), nënparagrafi 1 fshihet.

Neni 12

Në nenin 86, fjalët: “pengesa në zhvillimin mental ose trupor” fshihen.

Neni 13

Në nenin 93 paragrafët (1) dhe (2) fjalët: “pengesa në zhvillim” ndryshohen me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Neni 14

Në nenin 102-a në paragrafin (4) pas fjalëve “institucion i arsimit të lartë” shtohen fjalët “edhe shkollë private që është në cilësi të subjektit juridik”.

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), që thotë:

“(5) Në rast ndryshimi të emrit të institucionit për fëmijë, kopshtit/qendrës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve si njësi organizative në përbërje të subjektit juridik, institucionit të arsimit të lartë dhe shkollës private, pas kërkesës së parashtruar nga themeluesi, Ministri merr vendim për ndryshimin e emrit.”.

Neni 15

Në nenin 105, pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafë (7) dhe (8) si më poshtë:

“(7) Procedura e ndalimit të punës së objektit në përbërje të kopshtit publik të fëmijëve/qendrës publike për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, iniciohet dhe udhëhiqet prej themeluesit.

(8) Vendim për ndërprerjen e punës së objektit në përbërje të kopshtit publik të fëmijëve/qendre publike për zhvillimin e fëmijërisë së hershme merr Këshilli komunal i Komunës dhe Këshilli i Komunal i Qytetit të Shkupit”, pas mendimit paraprak të siguruar nga Ministria”.

Paragrafët (7), zëvendësohet me paragrafin (9).

Në paragrafin (8) i cili zëvendësohet me paragrafin (10), fjalët „ Paragrafi(7) zëvendësohet me fjalën paragrafi(9),,.

Në paragrafin (9),i cili zëvendësohet me paragrafin(11), zëvendësohet me fjalën paragrafi(8),, zëvendësohet me fjalët paragrafi(10),,.

Paragrafi(10) bëhet paragrafi (12).

Neni 16

Në nenin 113-a paragrafi (1), fjalët: “(1), (3) dhe (4)” ndryshohen me fjalët: “ paragrafët (1), (3), (4) dhe (5)”.

Paragrafi (2) ndryshon si më poshtë:

“(2) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm sipas nenit 78 paragrafi (1), nenit 88 paragrafi (1), nenit 102 paragrafi (1) dhe nenit 102-a paragrafët (1), (3), (4) dhe (5), i përcakton Ministri.

Neni 17

Në nenin 168 paragrafi (7), fjalët: “nevoja të veçanta” ndryshohen me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Në paragrafin (13), fjalët: “pengesa në zhvillim ndryshohen me fjalën: “aftësi të kufizuara”.

Neni 18

Në nenin 177-a paragrafi (2), nënparagrafi 2 fshihet.

Neni 19

Në nenin 179 paragrafi (3), fjalët “nënparagrafët 3, 4, 5 dhe 6” ndryshohen me fjalët “nënparagrafët 2, 3, 4 dhe 5”.

Neni 20

Në nenin 179-a paragrafi (3), fjalët “nënparagrafët 3, 4, 5 dhe 6” ndryshohen me fjalët “nënparagrafët 2, 3, 4 dhe 5”

Neni 21

Në nenin 212 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si më poshtë:

“(5) Udhëheqësi ose i autorizuari tjetër në institucion (qendra për punë sociale, institucioni për fëmijë, kopshti për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve të themeluara si njësi organizative në përbërje të subjekteve juridike, institucion i arsimit të lartë dhe shkollë private), agjencia për ofrimin e shërbimeve për ruajtje dhe përkujdesje të fëmijëve dhe persona fizikë që kryejnë punë të caktuara të veprimtarisë, janë të detyruar që inspektorit, në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, t’i sigurojnë kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes inspektuese dhe t’i vënë në dispozicion dhe këqyrje të gjitha mjetet dhe dokumentacionin e nevojshëm”.

Paragrafi (5) bëhet paragrafi (6).

Neni 22

Në nenin 214-a paragrafi (1) ndryshon si më poshtë:

“(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori përkatësisht inspektori i autorizuar, në kuadër të kompetencave të përcaktuara, konstaton se është kryer shkelje e nenit 226 paragrafëve (1), (2), (3), (4), (5) dhe (6) dhe paragrafi (7) nënparagrafët 2 dhe 3, neni 228 paragrafi 1, nënparagrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 23 dhe 24, paragrafi (2), paragrafi (3), paragrafi (4) alinetë 1, 2, 3, 5 dhe 6, paragrafi (5), paragrafi (6) dhe paragrafi (7) dhe nenet 229, 229-a, 230, 230-a, 230-b, 230-d, 230-e, 230- f dhe 230-h të

këtij ligji, inspektori, respektivisht inspektori i autorizuar me vendim shqipton vërejtje dhe përcakton afat brenda të cilit subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar t'i eliminojë parregullsitë dhe mangësitë, të përcaktuara në procesverbal”.

Pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri 8 i cili thotë:

“(8) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës për vërejtjet e shqiptuara i përshkruan Ministri”.

Neni 23

Neni 214-b fshihet.

Neni 24

Në nenin 26 paragrafin (7) shtohet nënparagraf i ri 1 si më poshtë:

“- nuk mundëson kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes inspektuese (neni 212 paragrafi 5),”.

Në nënparagrafin 1 që bëhet nënparagraf 2, fjalët: “212 paragrafi (5)” ndryshohen me fjalët “212 paragrafi (6)” dhe pika në fund të fjalisë ndryshohet me lidhëzën “edhe”

Pas nënparagrafit 2 shtohet nënparagraf i ri 3, i cili thotë:

“- nuk i kryen masat e shqiptuara inspektuese (neni 215).”.

Neni 25

Në nenin 228 paragrafi (4) pas nënparagrafit 4 shtohet një nënparagraf i ri 5, si më poshtë:

“-menjëherë pas përfundimit të afatit të përcaktuar për kryerjen e masës së inspektimit, dhe jo më vonë se tri ditë, nuk e ka njoftuar inspektorin me shkrim nëse janë kryer masat e inspektimit (neni 212 paragrafi (6)).”.

Neni 26

Procedurat e filluara për kërkesat për ushtrimin e së drejtës për shtesë të posaçme, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në përputhje me dispozitat që kanë vlejtur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Nenet 2 i këtij ligji me të cilat ndryshohet neni 32 dhe neni 3, i këtij ligji me të cilin ndryshohet neni 33, do të fillojnë të zbatohen në ditën e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor për vlerësimin funksional në përputhje me Ligjin e Përkujdesjes Sociale.

Neni 27

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon të ushtrohet/shfrytëzohet e drejta e fituar për shtesë të posaçme, në përputhje me dispozitat e neneve 32 dhe 33 të Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, numër 104/19, 146/19, 275/19 dhe 311/20), ndërkaq shfrytëzuesit me konstatim dhe mendim për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar të fëmijës, në të cilat është rekomanduar kontroll ose kategorizim i sërishë,, të drejtën për shtesë të posaçme do të vazhdojnë ta shfrytëzojnë deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në konstatimin dhe mendimin për kontroll-kategorizim të sërishëm dhe të njëjtit do të udhëzohen për vlerësim funksional në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 28

Dispozitat e nenit 11 të këtij ligji me të cilin në nenin 76 paragrafi (3), nënparagrafi 1 fshihet, neni 18 i këtij ligji, me të cilin në nenin 117-a paragrafi (2) nënparagrafi 2 fshihet, neni 19 i këtij ligji, me të cilin në nenin 179 paragrafi (3) nënparagrafët 3, 4, 5, dhe 6 bëhen nënparagrafë 2, 3, 4 dhe 5 dhe neni 20 i këtij ligji, me të cilin në nenin 179-a paragrafi (3) nënparagrafët 3, 4, 5 dhe 6 bëhen nënparagrafë 2, 3, 4, dhe 5 do të fillojnë të zbatohen në ditën e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

Neni 29

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 30

Autorizohet Komisioni Juridiko-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të zbardhur të Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.